



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister**

Nr. 137/2020  
Datë: 23.04.2020

Kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 94 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 6 (2.1) dhe nenin 11 (1) të Rregullores Nr. 05/2020 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

**V E N D I M**

1. Znj. Alma Dushi Kabashi emërohet Zëvendësministre në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim.
2. Zëvendësministrja emërohet për mbështetjen e Ministrit për Komunitete dhe Kthim dhe është përgjegjëse për menaxhimin e aktiviteteve në fushat e përcaktuara nga Ministri, si dhe për zëvendësimin e Ministrit kur ai mungon ose kur nuk është në gjendje të kryejë detyrën e tij.
3. Zëvendësministrja, brenda tridhjetë (30) dite nga hyrja në fuqi e këtij Vendimi është e obliguar të bëjë deklarimin e pasurisë, në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-228 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-050.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryeministri.

**Albin KURTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

*Vendimi i dërgohet:*

- Znj. Alma Dushi Kabashi, Zëvendësministre në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim
- Të gjithë Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë Ministrave;
- Shefit të stafit të Kryeministrit;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.